

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që kjo rezolutë është e domosdoshme jo vetëm për të na vendosur ne në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të NATO-s apo të Bashkimit European, por edhe për të pasur një reflektim të thellë si ligjvënës dhe si shqiptarë për atë çka ndodh në rajonin tonë. Shkatërrim, vrasje e njerëzve të pafajshëm, kërcënim nukleare, shpopullim masiv, ky është krimi që ka një fytyrë dhe një emër të Vladimir Putinit! Fatkeqësisht, kjo është situata për njerëzit dhe qytetarët e Ukrainës nga pushtimi rus, dhe kjo ishte e paimagjinueshme, por dua t'ju kujtoj, kolegë deputetë, ta kemi memorien pak të gjallë për atë çfarë ka ndodhur në Ballkan, sepse spastrimi etnik në Kosovë, vrasjet makabre në Bosnjë-Hercegovinë kanë akoma në politikën e rajonit njerëz që janë aktivë, jo vetëm pa kërkuar ndjesë, por kërkojnë të rrisin autoritetin dhe pushtetin e tyre! Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj disa fakte, që tregojnë se kjo që po ndodh në Ukrainë nuk ishte një gjë e rastit. Në muajin shkurt të vitit 2007 në Konferencën e Sigurisë në Mynih, Vladimir Putin, për herë të parë, ka deklaruar: “Bota nuk është më unipolare. Rusia është kthyer tashmë si pjesë e rëndësishme e rendit botëror dhe si një faktor i rëndësishëm gjeopolitik”. Ai deklaroi më tej se NATO-ja është rrezik dhe zgjerimi i saj në vendet rreth Rusisë përbën një kërcënim për sigurinë e Rusisë.

Po ashtu kundërshtoi fuqishëm si kërcënim për Rusinë ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes raketore-balistike të Shteteve të Bashkuara në Poloni dhe në Çeki asokohe. Po në të njëjtin fjalim, të nderuar kolegë deputetë, ai ka deklaruar: “Ballkani është back yard-i i Rusisë dhe nuk do ta lejojmë zgjerimin e NATO-s edhe në Ballkan”. Atë vit pata mundësinë të kisha një takim me drejtorin e Inteligjencës së NATO-s, i cili na bëri me dije se duhej të bënim kujdes se Shqipëria mund të përballej me akte të ndryshme përpara marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO. Po ashtu provoi se që Rusia që ndërhyri në Malin e Zi në një puç dhe në një përpjekje për ekzekutimin e presidentit të Malit të Zi, për të mos lejuar anëtarësimin në NATO. Në Bullgari dhe në Rumani veprimtaria supresive e rusëve ka qenë prezente me shpërthime dhe Çekia ka larguar nga vendi 18 diplomatë rusë, po ashtu ka bërë edhe Rumania, edhe Bullgaria. Inteligjenca ruse, të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit, ka tentuar prej kohësh të rekrutojë ushtarakë dhe të tjerë në territorin e Shqipërisë. Në Nish është një nga qendrat më të fuqishme të inteligjencës dhe të spiunazhit rus. Rusia ka ndërtuar një makineri dezinformuese medietike shumë të fuqishme, prezente sot në Ballkan. Do të ishte mirë që sidomos Komisioni për Sigurinë në Kuvendin e Shqipërisë të shohë dhe të vlerësojë të gjitha raportet e Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Shërbimit Informativ të Ushtrisë për aktivitetin që ndodh në Tiranë nga prezenca ruse në interesa tërësisht antishqiptare.

Atëherë, do të kuptojmë se kë kemi mik dhe kë kemi kundërshtar. Në vitin 2008 Putini sulmoi Gjeorgjinë dhe mungesa e një reagimi të vendosur të Perëndimit i dha atij mundësinë në vitin 2014 për të vepruar ushtarakisht dhe për të aneksuar Krimenë, prandaj edhe kjo që ndodhi në Ukrainë nuk ishte rastësi, por një plan i mirëpërgatitur nga Putini. Para një muaji, në një takim me ishkomandantin Suprem të NATO-s, gjeneralin Xhim Xhons, dhe njëkohësisht National Security Adviser-in e Presidentit Obama, ai tregonte që në një takim me Putinin, për më shumë se një orë, problemi më i madh që

kishte dhe diskutonte ishte kolapsi i Bashkimit Sovjetik. Këtë e vendoste pikërisht në një sjellje tërësisht agresive të NATO-s karshi Rusisë. Po ashtu, ju kujtoj që në konfliktin në Siri Putini mori qëndrimin në mbështetje të Asadit, i cili sot, po ashtu, është në pushtet. I thashë të gjitha këto sa më sipër, të nderuar kolegë deputetë, sepse kjo që po ndodh në Ukrainë ka qenë e përgatitur dhe e mirëmenduar nga Putini. Rikthehesh këtu sot atë që deklarova në Asambleenë Parlamentare të OSBE-së në Vjenë para disa ditësh: “Pa mëdyshje, Shqipëria dënon pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Putini ka sulmuar ushtarakisht një vend të pavarur dhe sovran, duke kryer krime kundër njerëzimit. Kjo do të jetë një luftë e gjatë, të nderuar miq, ku lidhshipi dhe populli i Ukrainës kanë vendosur të mbrojnë vendin dhe lirinë e tyre”. Në një shkëmbim me mikun tim, ishministrin ukrainas të Mbrojtjes, Anatoli Grushenko, kur i ofrova mbështetjen për familjen e tij, ai më shkruante: “Duke ju falënderuar për solidaritetin, ne po luftojmë dhe do të bëjmë çdo gjë për ta ndaluar Putinin. Ajo që do të na ndihmonte do të ishte nëse NATO-ja do të vendoste no-fly zone në Ukrainë, se të tjerat dimë t’i bëjmë vetë shumë mirë”. Fatkeqësisht, kjo nuk u mor parasysh në takimin e fundit të NATO-s!

Unë nuk kam as forcën, as arsien për të gjykuar ndryshe nga ajo që gjykoi NATO-ja, por do të ketë shumë viktime, do të ketë një dhimbje të madhe për popullin e Ukrainës dhe këtu duhet që ne të jemi pak më konkretë në solidaritetin tonë me vëllezërit tanë nga Ukraina, sepse para një muaji apo dy muajsh, askush në Ukrainë nuk e vinte në dyshim mundësinë e ardhjes së NATO-s apo të Bashkimit Europian në Ukrainë, apo se do të ndodhte kjo që ndodhi. Prandaj është mirë të sillemi si shqiptarë dhe jo si udhëheqës të botës. Shumë gjëra ndryshojnë shpejt në gjeopolitikë, shumë marrëdhënie bëhen të pasigurta. Prandaj kemi detyrimin të shohim se çfarë po ndodh në rajonin tonë dhe çfarë efektesh do të ketë mbi shqiptarët. Të mos bëjmë gabim dhe të mendojmë se Ukraina është vetëm ajo që do Putini. Ukraina është target, por qëllimi i Putinit është më tej, është Europa dhe, pse jo, ndërtimi i konflikteve në Ballkan. Ndoshta jo vetëm drejtpërdrejt, por edhe me shtetet proxy apo me ata që kanë mbështetur politikën e Putinit. Prandaj e ka zgjeruar sot edhe prezencën ushtarake dhe inteligjente, edhe atë medietike në rajonin e Ballkanit. Rusia është prezente sot në Ballkan ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht me struktura të zbulimeve inteligjente dhe medie të organizuara për të manipuluar opinionin publik. Në Ballkan ka një aleat të hapur të Rusisë dhe të Putinit, kjo është Serbia dhe Vuçiçi. Ashtu si rusët dhe Putini, që duan të rikthejnë Bashkimin Sovjetik, edhe ata kanë të njëjtën ëndërr, të rikthejnë ish-Jugosllavinë. Një Serbi e fuqishme politikisht, të nderuar kolegë deputetë, ekonomikisht dhe ushtarakisht është padyshim një interes madhor për Rusinë dhe kontrollin e Ballkanit. U bë pothuajse tre muaj kur kanë mbërritur këtu me shqetësim tensionet në Ballkan.

Përgatitem edhe një rezolutë me kolegë deputetë të opozitës, ndërkohë sot më thonë që ka dalë edhe një rezolutë tjetër. Shumë mirë, bëjmë rezoluta pa fund! Po të ulemi dhe të mendojmë se çfarë duhet të bëjmë ne si shqiptarë në këtë situatë, sepse gjatë takimit në Vjenë, po ju them që përfaqësuesit e Kongresit Amerikan, të Bundestagut, po edhe në vizitën e fundit që pata në Londër, në parlamentin britanik, shqetësimi është se Ballkani ka probleme të sigurisë. Shqetësimi është se Ballkani mund të shfrytëzohet nga Rusia për të krijuar tensione, prandaj duhet të mendojmë si duhet të bëhemi pjesë aktive për të parandaluar me partnerët tanë Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n. Në qoftë se nuk duam të dëgjojmë njëri - tjetrin, të dëgjojmë sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, të dëgjojmë Parlamentin Europian apo Kongresin Amerikan për atë çka thotë, se mund të ndodhë në Ballkan. Po ashtu, edhe vëllezërit tanë në Kosovë kanë filluar të flasin hapur dhe qartë për mundësinë e rrezikut të një konflikti të nxitur nga Serbia. Prandaj ne duhet të sillemi si deputetë me bindjen për të bërë atë që është më e mira për vendin tonë dhe për shqiptarët.

Të nderuar kolegë deputetë, Më lejoni të parashtoj edhe një herë këtu, para jush, me fakte, se çfarë e kërcënon Serbinë, që në kushtet e një krize ekonomike shpenzon mbi 2 miliardë dollarë, çdo vit, për

të blerë pajisje dhe armatim nga Rusia dhe nga Bjellorusia. Serbia ka shpenzuar 2 miliardë dollarë, duke blerë avionë MiG-29 nga Rusia dhe nga Bjellorusia, po ashtu tanke T-72, automjete të blinduara me sisteme mbrojtëse ajrore Pantsir S1. Në janar ka marrë një ngarkesë me raketa antitank Kornet. Pra, kjo është një politikë që nuk ka të bëjë me mbrojtjen, por me ofensivën, prandaj ne duhet të kemi një përgjigje. I vetmi vend në rajonin e Ballkanit, që është përgjigjur sot, është vetëm Kroacia, kurse ne bëjmë diskutime pa dëgjuar njëri-tjetrin dhe pa parë se çfarë duhet të bëjmë. Po ashtu, edhe mosmarrëveshja në kufirin verior të Kosovës duhet të na tërheqë vëmendjen. Prandaj mendoj se është shumë e rëndësishme që çështjen tonë të sigurisë, mos ta shikojmë thjesht dhe vetëm në komponentët ushtarakë, por edhe në komponentët politikë, ekonomikë dhe teknologjikë.

Të nderuar kolegë deputetë, ne duhet, qartësisht, të vendosim disa norma në marrëdhëniet tona si parlamentarë. Kam 5 propozime për këtë. Së pari, moslejimin e zgjerimit të autoritetit politik, ushtarak dhe ekonomik të Serbisë, për më tepër përfshirje me nisma, që mund t'i krijojnë asaj hapësira më të mëdha në rajonin e Ballkanit, se kjo do të thotë që të kemi më tepër prezencë dhe rrezik nga Rusia. Së dyti, çdo nismë rajonale, si në aspektin politik, edhe ekonomik, duhet patjetër të ketë diskutimin dhe dakordësinë e faktorit politik shqiptar në rajon. Së treti, parlamenti duhet të informohet, të konsultohet për qëndrimet që ka qeveria shqiptare në raport me NATO-n, Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe veçanërisht me ato që kanë të bëjë me samitin e ardhshëm të NATO-s, për rolin dhe mundësinë e akselerimit më shumë të marrëdhënieve të NATO-s në rajonin e Ballkanit. Së katërti, kemi Këshillin e Sigurisë Kombëtare, por nuk e kemi, duhet që ne si deputetë të marrim përgjegjësinë që Këshilli i Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë të funksionojë në bazë të një ligji dhe të përgjegjësive përkatëse të çdo autoriteti ekzekutiv, parlamentar, të shërbimeve apo të ministrive të ndryshme. Së pesti, në këtë situatë është e domosdoshme të krijohet një forum parlamentar, joformal ndër shqiptarë, me të gjithë faktorët politikë në rajonin e Ballkanit, që do të na bënte të flisnim si shqiptarë me qartësi dhe me bindjen se cili është interesi dhe ardhmja e shqiptarëve në Bashkimin European. Faleminderit!